VENDIM
Nr.485, datë 23.6.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.191, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VENDOSJEN E OPONENCËS TEKNIKE SHTETËRORE PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE, ME KONCESION", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të neneve 4, 6, 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 29.7.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.191, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, pas fjalëve "…Për të gjitha projektet e propozuara…" shtohen "…si dhe projektet e zbatimit…".

2. Në fund të pikës 3 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"…si dhe oponencën e projekteve të zbatimit, sipas udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi…".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha